






Republika e Kosovës - Komuna e Suharekës
Republika Kosova- Opstine Suvareka
Republic of Kosovo-The Municipality of Suhareka



Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim

Nr-DATË/A:	07Nr.233 /350-25884 datë 23.07.2020
REFERENC-Ë:	07Nr.350/25884 datë 26.06.2020
PËR/TO:	Shkëlqim Bali Ramaj, Reqan-Suharekë
KOPJE/COPY:	Drejtorinë e Inspeksionit, Dosje të Drejtorisë
NGA/FROM:	Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim
	DREJTOR: Sanie KUQI <i>Zyrtare e lartë për ndërtimtari:</i> Doruntina Bytyqi ing.dipl.ndërt. 
LËNDA/SUBJECT:	Aktvendim mbi Leje Ndërtimore

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim, ka pranuar kërkesën 07Nr.350/25884 datë 26.06.2020 nga **Shkëlqim Bali Ramaj, Reqan-Suharekë**, për Leje Ndërtimore për objektin e përkohshëm me destinimin Byfe për nevoja të shkollës, në parcelën kadastrale 02785-79, Tërësia 4/1, me numër referues të çertifikatës Nr.1340/2020 datë 09.03.2020, Pasuri Shoqërore Shfrytëzues i Përhershëm Kuvendi Komunal Suharekë, sipas kontratës për dhënjën në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës së Suharekës 01Nr.016-14315 datë 04.03.2020, andaj pas shqyrtimit të kërkesës ky organ vendos, si në Aktvendimin e bashkangjitur kësaj shkrese.

- **AKTVENDIM MBI LEJEN NDËRTIMORE**



Republika e Kosovës - Komuna e Suharekës
Republika Kosova- Opstine Suvareka
Republic of Kosovo-The Municipality of Suhareka



Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim

Data: 23.07.2020

Numri i vrojtimit i lejes:

07Nr.233/350-25884

Në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr.04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21, Udhëzimit Administrativ Nr.08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor, Ligjit për Procedurën Administrative Nr.05/L-031, Rregullores mbi Rregullat dhe Procedurat për Ndërtimin e Objekteve 01-Nr-16-423, datë 26.01.2011, Rregullore për tarifa nga shërbimet dhe veprimtaritë komunale 01Nr-16-9367, datë 31.12.2014; neni 2, pika 2.1 dhe 2.2 si dhe sipas Planit Zhvillimor Urban 01Nr.5820 datë 05.03.2008, duke u mbështetur në Planin Rregullues Urban "Zona Industriale Shirokë" 01 Nr.10074 datë 21.04.2009, Kontratës për dhënjën në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës së Suharekës 01Nr.016-14315 datë 04.03.2020 kërkesës dhe dokumenteve të paraqitura nga Shkëlqim Bali Ramaj, Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim lëshon këtë :

AKTVENDIM
(MBI LEJE NDËRTIMORE)

Kjo leje ndërtimore i lëshohet:			
Emri:	Shkëlqim Bali Ramaj	Nr. Personal	
Adresa:	rr."Lulzim Veselaj" Reqan, Suharekë	Telefoni:	
Email :		Kërkesa Bazë:	Aplikim për leje ndërtimore: 07Nr.350/25884 datë 26.06.2020

Emri i Projektit:	Byfe për nevoja të shkollës		
Emri i Projektuesit:	"Ndërtimi i Byfes në Shkollën e Mesme Avdyl Rama"		
Adresa:	"Muharrem Fejza" p.n Lagja e Siptalit, Prishtinë		
Telefoni:		Emaili:	

Për punët ndërtimore në vijim: NDËRTIM I RI - Objekti II (përkohshëm) në kuadër të parcelës			
Adresa: Rr "Ukë Bytyqi", Shirokë			
Zona(t) Kadastrale: Suharekë	Nr. i parcelës kadastrale:	GPS Koordinatat e objektit:	
Sipas certifikatës me Nr. Nr.1340/2020 datë 09.03.2020 Zona Kadastrale Suharekë	02785-79	X=4689667.115 X=4689670.568 X=4689660.657 X=4689657.204	Y= 7484253.028 Y= 7484272.609 Y= 7484274.356 Y= 7484254.775

Lloji i ndërtimit të propozuar:
Byfe për nevoja të shkollës
Kategoria e ndërtimeve të propozuara:

Kategoria II			
Gabariti	10.06m' x 19.88m'	Katshmëria:	(P+0), sipërfaqe të përgjithshme Bruto 200m ²
Vija rregullative	Nga mesi i rrugës A-A "Ukë Bytyqi" 16.0m'	Vija ndërtimore	Nga vija rregullative e rrugës "Ukë Bytyqi" 15m'

Përshkrimi
Me këtë vendim, poseduesit të lejës ndërtimore <i>Shkëlqim Bali Ramaj nga Reqani, Suharekë</i> i lejohet ndërtimi i objektit të përkohshëm me destinim Byfe për nevoja të shkollës, me etazhitet P+0. Lokacioni i objektit është në kuadër të Planin Rregullues Urban "Zona Industriale Shirokë" 01 Nr.10074 datë 21.04.2009, ku sipas gjendjes së planifikuar, në parcelën kadastrale 02785-79, është me destinim Shkollë e mesme. Objekti ka karakter të përkohshëm me katshmëri P+0. Ndërtimi i objektit të bëhet konform Kushteve Ndërtimore të lëshuara nga ky organ: 07Nr.101/350-15873 datë 31.03.2020. Kjo leje ndërtimore lëshohet në bazë të aplikacionit dhe informatave mbështetëse. Ndërtimi do të bëhet në përputhje me dokumentet e aprovuara ndërtimore. Çfarëdo ndryshimi i projektit duhet të aprovohet nga hartuesi i projektit dhe nga ky organ. Poseduesi i Lejës Ndërtimore është i obliguar që: • Puna në ndërtim duhet të fillojë brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj leje ndërtimore, përveç nëse zgjatet afati i vlefshmërisë së saj në pajtim me Ligjin. • Të vendos tabelën informuese në vendndërtim me informata e mëposhtme: - Informata mbi Lejën Ndërtimore; - Informata mbi Projektuesin; - Informata mbi Kontraktuesin; - Prezantimi grafik i dukjes së ndërtimit. • Duhet të siguroheni se kontraktuesi në vendndërtim i posedon dokumentet e mëposhtme: - Një kopje të kësaj leje ndërtimore; - Nëse punët ndërtimore kryhen nga një palë e tretë, një kopje e kontratës ndërmjet poseduesit të lejes ndërtimore dhe kontraktuesit; - Një kopje e të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të "APROVUAR" nga organi kompetent; - Projektin Kryesor me të gjitha fazat për nevoja të realizimit të ndërtimit; - Dokumentacioni që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, Kodin dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit; - Librin dhe ditarin e ndërtimit, që duhet të përmbajnë regjistër të hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore; përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur; - Protokolet e miratuara të nevojshme për aplikim për çertifikatë të përdorimit - Të dorëzojë njoftim inspektoratit të Organit Kompetent për fillimin e ndërtimit së paku shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore; - Të njoftojë organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj dhe akte nënligjore. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin apo

0000000000

.....

.....

.....

inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuate dhe mbikëqyrje ditore të punëve ndërtimore.

- Të njoftojë organin kompetent për ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga Projektuesi. Poseduesi i Lejës Ndërtimore duhet të njoftojë organin kompetent për të gjitha ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi përveq në rastet kur:
 - o Ndryshimet nuk janë në kundërshtim me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret në fuqi;
 - o Ndryshimet në dimensionet e pjesëve të jashtme të ndërtimit nuk tejkalojnë 2% dhe zero presje një(0.1) metër por që nuk tejkalojnë vijën ndërtimore;
 - o Ndryshimet në organizimin e brendshëm janë në harmoni me Kushtet Ndërtimore, kodet dhe rregulloret teknike në fuqi;
- Nëse gjatë punimeve haset në elemente arkeologjike, investori është i obliguar ti ndërpresë punimet dhe të njoftojë organet komunale.
- Obligohet investori që gjatë gërmimit dhe ndërtimit të objektit të bëjë pastrimin e materialit të panevojshëm për punë dhe se të njëjtin ta transportojë në deponinë për trajtimin dhe deponimin e mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore, në lokacionin e përcaktuar nga Kuvendi i Komunal.
- Pas përfundimit të punëve ndërtimore, të aplikojë për certifikatë të përdorimit në pajtim me ligjin dhe aktet nënligjore.

A r s y e t i m

Aplikuesi *Shkëlqim Bali Ramaj nga Reqani, Suharekë* përmes kërkesës 07Nr.350/25884 datë 26.06.2020 ka kërkuar nga organi kompetent lëshimin e Lejës Ndërtimore për ndërtim të objektit të përkohshëm Byfe për nevoja të shkollës, sipas projektit të bashkangjitur.

Kjo leje ndërtimore bazohet në shqyrtimin e provave:

- Aktvendimi mbi Kushtet Ndërtimore 07Nr.101/350-15873 datë 31.03.2020 (kopje)
- Dëshmi për pagesën e taksës sipas njoftimit 07Nr.221/350-25884, datë 21.07.2020, në shumë prej 560€, e paguar në Villesa-CO në Suharekë, sipas faturës komunale nr.0000550 datë 21.07.2020.
- Pëlqim për kushtet e sigurisë në komunikacion rrugor – nga Inspektori i Komunikacionit Rrugor 09Nr.185 datë 17.07.2020.
- Pëlqim sanitar – nga Inspektori i Sanitar 09Nr.184 datë 17.07.2020.
- Pëlqim për menagjimin e mbeturinave Nr.prot.68/20 datë 06.05.2020, lëshuar nga NPRM “ECO-REGJIONI”- Prizren, Njësia operative Suharekë.
- Pëlqim për kyqje në rrjetin publik të Ujësjellësit dhe Kanalizimit –Hidroregjioni Jugor Prizren Nr.31 datë 06.05.2020.
- Pëlqim për rregullim të dokumentacionit teknik, KEDS-SH.A, Nr.422 datë: 14.05.2020.
- Pëlqimin për rmbrojtjen nga zjarri - nga Drejtoria për Shërbime Publike Mjedis dhe Emergjencë Nr.03/03-73 datë 20.07.2020.
- Kopje e planit dhe çertifikata e pronësisë
- Kontratën mbi të drejtën e shfytëzimit të parcelës 01Nr.016-14315 datë 04.03.2020
- Matjet gjeodezike nga N.P.SH "GJEODEZIA" date 10.03.2020
- Vërtetimin e tatimit në Pronë
- Kopje e dokumentit identifikues

06.04.2025

Ky organ përmes shërbimit të vet profesional pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumenteve tjera përcjellëse, bazuar në Ligjin Nr.04/L-110 për Ndërtim, konform Planin Rregullues Urban "Zona Industriale Shirokë" 01 Nr.10074 datë 21.04.2009, Kontratës për dhënjën në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës së Suharekës 01Nr.016-14315 datë 04.03.2020 ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e Lejes Ndërtimore, andaj u vendos si në dispozitiv.

Udhëzim juridik: Kundër kësaj Leje Ndërtimore pala e pakënaqur mund t'i paraqitet ankesë MEA në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e dorëzimit përmes këtij Organi.

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim – Komuna Suharekë
Numri i vrojtimit i lejes 07Nr.233/350-25884 datë 23.07.2020

Vendimi i dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Inspektoratit të Komunës;
- Dosjes së DUP-së

DREJTORI:
Sanie KUQI

